

Nr. 2127 / Prot
Datë 12.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

- Sel. Këshillit Bashkiak
- Dr. Juridike
- Sel. Përgjithshëm
- Dr. Bënorovca

Nr. 390/prot.

Durrës, më 09.09.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

SHIJAK

KRYETARIT TË BASHKISË

SHIJAK

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Shijak Nr.31 datë 29.08.2025, " Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI



planet e trajnimeve, administron dhënjën e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulente ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin e emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Shijak në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Shijak në masën 287.515 leke si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimin dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Shijak të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta *“Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”*, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Shijak të përfaqësojë Bashkinë Shijak në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Shijak nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.
6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, të ndryshuar.

KRYETARI
Sulejman Tola

